



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

**Rasti: Deutsche Telekom AG – OTE(Hellenic Telecommunication Organization)**

1. Në datën 21 Maj 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja a të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me objekt përfitim të kontrollit nga shoqëria Deutsche Telekom AG me seli në Gjermani, në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA (OTE), me seli në Greqi.
2. Ky transaksion konsiston në blerjen e “një pakice kontrolli” (5.03% të aksioneve) dhe të së drejtës së votës për të ushtruar kontrollin influencues në manaxhimin e shoqërisë OTE nga DTAG. Marrëveshja e aksionerëve dhe marrëveshja e shitjes së aksioneve është nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në datën 14 Maj 2008 dhe është miratuar nga Parlamenti Grek në datën 19 qershor 2008
3. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse: Ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Autoriteti gjeti, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit. Njera nga palët pjesëmarrëse OTE SA, është e pranishme në mënyrë të tërthortë në tregun e Republikës së Shqipërisë, në shoqërinë AMC ShA, nëpërmjet filialit të tij kryesor Cosmote Group. Në zbatim të nenit 12, pika 1, shkronja a e Ligjit, përqendrimi i njoftuar do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregulloren “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”.
5. Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën [perqendrimi@caa.gov.al](mailto:perqendrimi@caa.gov.al)**